



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, deklaratat përmbyllëse përfunduan këtë javë. Gjatë deklaratave përmbyllëse Prokuroria, Mbrojtja dhe Mbrojtja e Viktimave paraqitën argumentet e tyre të fundit dhe të akuzuarit dhanë deklaratat pa betim.

Pasi Trupi Gjykesues e shpalli të mbyllur çështjen më 18 shkurt, ai tani do të fillojë kuvendimet për të marrë vendimin e gjykit brenda 90 ditësh. Në qoftë se rrethanat kërkojnë kohë shtesë, afati mund të shtyhet për 60 ditë.

Gjykatësit do të vlerësojnë me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë dhe peshën e dëshmive të dëshmitarëve dhe të secilës provë.

Trupi Gjykesues vendos veçazi për secilën akuzë, përfshirë për secilën formë përkatëse të përgjegjësisë penale. Në rastet e gjyqimeve të përbashkëta siç është ky, konstatimet bëhen më vete për secilin të akuzuar.

Të akuzuarit prezumohen të pafajshëm, përveç nëse prokuroria vërteton fajësinë e tyre jashtë dyshimit të arsyeshëm.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit për pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, deklaratat hyrëse janë planifikuar të mbahen të premtën që vjen, më 27 shkurt.

Seanca është planifikuar të fillojë në orën 9:30 dhe të përfundojë në orën 16:00. Atë mund ta ndiqni në internet në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte, përmes transmetimit në faqen e internetit të DHS-së, me 45 minuta vonesë, ose nga galeria për publikun në ndërtesën e Dhomave të Specializuara.

Për të ndjekur seancën nga galeria për publikun në ndërtesën e gjykatës në Hagë, nevojitet regjistrim paraprak. Ju lutemi mbani parasysh se afati për regjistrim paraprak është deri nesër, 20 shkurt.

Gjatë deklaratave hyrëse, Prokuroria dhe Mbrojtja kanë mundësinë të paraqesin përmbledhje të përgjithshme të argumenteve të tyre dhe shpjegim përmbledhës të provave që do të paraqiten. Sipas Rregullores, ekipet e Mbrojtjes mund të vendosin nëse do t'i bëjnë deklaratat hyrëse të tyre pas asaj të Prokurores së Specializuar, ose më vonë, pas përfundimit të paraqitjes së provave nga Prokurorja e Specializuar, ose të mos bëjnë deklaratat hyrëse.





Më 27 shkurt, Prokuroria do të bëjë deklaratën hyrëse të saj. Bazuar në parashtrimet publike të deritanishme, Mbrojtja e z. Thaçi dhe e z. Fazliu kanë bërë të ditur se do t'i bëjnë deklaratat e tyre në këtë kohë. Pas deklaratave hyrëse, Prokuroria do të thërrasë dëshmitarin e parë nga tre dëshmitarët e saj.

Sa u përket hapave të ardhshëm, Prokuroria pritet të paraqesë provat dhe argumentet e veta dhe të thërrasë dëshmitarë gjatë javës së ardhshme. Mbrojtja do të ketë mundësinë të marrë në pyetje dëshmitarët. Seancat e gjyqimit janë planifikuar nga 2 deri më 6 mars.

Prokuroria pretendon se midis së paku 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të ndryshme të paprivileguara në objektin e paraburgimit, z. Thaçi u dha zotërinjve Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi informacion konfidencial për dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria në çështjen gjyqësore për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, i udhëzoi ata që të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve, dhe u dha hollësi se si të vepronin.

Në Aktakuzë më tej pretendohet se z. Thaçi bashkërendoi tre grupe, të përbëra nga zotërinjtë Smakaj, Fazliu dhe Kilaj dhe persona të tjerë për të cilët nuk janë ngritur akuza, dhe nga z. Kuçi, me qëllimin e ndërhyrjes në dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria në gjykimin aktual për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*.

Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore janë vetëdeklaruar të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 12 shkurt, Gjykatësi i Vetëm hodhi poshtë kërkesat e Mbrojtjes së Thaçit dhe të Kilajt për leje për apelim të një vendimi të mëparshëm të Gjykatësit të Vetëm, në të cilin ai konstatoi se një deklaratë dëshmitari nga çështja e z. Thaçi për krime lufte ishte e pranueshme si provë në këtë çështje gjyqësore.

Gjykatësi i Vetëm e hodhi poshtë kërkesën, duke konstatuar se vendimi i mëparshëm i tij ishte keqinterpretuar dhe se Mbrojtja thjesht kishte shprehur mospajtim me atë vendim.

Më 11 shkurt, Gjykatësi i Vetëm miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve dhe parashtrimeve në çështjen gjyqësore për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*. Gjykatësi i Vetëm vuri në dukje gjithashtu se, për të bërë konstatim gjyqësor të një fakti të njohur botërisht, ai duhet të jetë relevant, logjikisht i pakundërshtueshëm, i përcaktuar mjaftueshmërisht qartë, të mos përmbajë konstatime që janë në thelb të llojit juridik në kuadër të procesit në të cilin bëhet ky konstatim, dhe të mos jetë vërtetim i përgjegjësisë penale të të akuzuarve.

Duke pasur parasysh se Mbrojtja nuk u pajtua me cilësimin e disa provave materiale dhe parashtrimeve në fjalë, Gjykatësi i Vetëm nuk bëri konstatim gjyqësor lidhur me vlerën e vërtetësisë së përmbajtjes së parashtrimeve ose provave materiale, por vetëm të faktit se parashtrimet në fjalë ekzistojnë dhe se palët janë në dijeni të përmbajtjes së tyre.





Më 18 shkurt, Gjykatësi i Vetëm hodhi poshtë pjesërisht një Kërkesë të Përbashkët të Mbrojtjes për Rishqyrtim dhe Sqarim të vendimit të mëparshëm të Gjykatësit të Vetëm mbi Kërkesën e Prokurorisë në lidhje me Afatin për Verifikim të Transkriptit/Përkthimit.

Mbrojtja ka kundërshtuar disa transkripte dhe përkthime të audioincizimeve të paraqitura nga Prokuroria dhe kërkoi ndryshime dhe sqarime përmes vendimit të Gjykatësit të Vetëm, për verifikimin e saktësisë së transkripteve ose përkthimeve në fjalë.

Në vendim, Gjykatësi i Vetëm sqaroi se Njësia e Përkthimit e Dhomave të Specializuara mund të japë sugjerime metodologjike që i gjykon të përshtatshme në kuadër të rishikimit prej saj të transkripteve dhe përkthimeve të kundërshtuara, në veçanti kur kjo është e nevojshme për të specifikuar llojin e saktë të gabimit të evidentuar.

Gjykatësi i Vetëm e ndryshoi *proprio motu* vendimin e tij të mëparshëm, për të urdhëruar Mbrojtjen që të dorëzojë vulat kohore të pjesëve që duhet të rishikohen, në qoftë se i di se cilat janë. Më pas, Prokuroria do të verifikojë pjesën në fjalë përpara se t'i përgjigjet Mbrojtjes.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, javën që shkoi u bënë publike dy vendime me të cilat Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesa të Prokurorisë për të shtuar dy materiale në listën e provave materiale të saj. Ato përfshijnë mesazhe të shkruara dhe materiale të nxjerra nga një telefon mobil, që Prokuroria konsideron se mbështesin argumentet e veta.

Këtë javë u bë publik një vendim i nëntorit 2025, që ka të bëjë me kërkesën e Prokurorisë për qasje në dokumente që pretendohet se janë printuar në objektin e parburgimit të Dhomave të Specializuara në vitin 2023, që sipas vlerësimit të Prokurorisë, i referohen një dëshmitari. Gjykatësi urdhëroi Zyrën Administrative të ndërmarrë hapa për ta marrë dokumentin e nxjerrë nga kompania e jashtme për kriminalistikë, duke siguruar konfidencialitet të rreptë, dhe ta bëjë gati dokumentin për shqyrtim nga Mbrojtësja e Pavarur. Mbrojtësja e Pavarur do të sigurojë që asnjë dokument ligjërishit i privilegjuar dhe asnjë dokument tjetër që nuk ka të bëjë me çështjen të mos i dorëzohet Prokurorisë.

